

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.15.05.2023*

**15.05.2023
Ora 12.37**

RENDI I DITËS

**“Shqyrtimi i kërkesës nr. 28, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me objekt
“Vendosje të sanksioneve administrative””.**

PJESËMARRJA:

- **KAS-i:** **Z. Elvin Lako, Z. E. Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.**
- **Stafi i KQZ-së:** **Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema.**
- **Të tjerë:** **KRIIK**

Z. E. Çefa: Mirdita! Fillojmë seancën e shqyrtimit lidhur me kërkesën numër 28, datë 12 maj 2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për vendosje sanksioni administrativ ndaj titullarëve, disa titullarëve të policive bashkiake në territorin e disa bashkive në territorin e Shqipërisë. Më saktë bëhet fjalë për vendosjen e sanksionit për 57 drejtues të policive bashkiake sipas listës së vendimit propozues të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Verifikojmë fillimisht pjesëmarrjen. Është prezent trupa e plotë e KAS-it. Është prezent sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së dhe stafi i tij nga administrata. Sipas shortit relator i kësaj çështjeje jam caktuar unë, anëtari Elvis Çefa. Në seancën paraprake kemi bërë dhe deklaratat përkatëse. Pra nuk kishte deklaratat përkatëse nga anëtarët e KAS-it për konflikt të mundshëm interesi, kështu që nuk kemi pengesë për të vazhduar. Konstatojmë se nuk ka prezencë të asnjë pale të interesuar. Nuk e dimë nëse kanë marrë dijeni institucionet përkatëse, sepse emra personash ne nuk kemi në listën e Komisionerit, por institucionet përkatëse janë njoftuar për zhvillimin e kësaj seance?

**Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ**

P. [Signature]

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.15.05.2023*

Z. Y. Merkaj: Po.

Z. E. Çefa: Atëherë, pa humbur kohë ia jap menjëherë fjalën sekretarit të Përgjithshëm. Me dy fjalë, ju lutem, të na relaton rastin.

Z. Y. Merkaj: Organizata KRIIK, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve sinjalizimin mbi afishimin publik të materialeve propagandistike zgjedhore të subjektit zgjedhor Partia Socialiste, i cili është në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor. Nga verifikimi i monitoruesve konstatohet se asnjë prej posterëve të publikuar nga subjektet zgjedhore nuk respektojnë parashikimet e pikës 3 të nenit 97 të Kodit Zgjedhor, i cili parashikon se posterët duhet të shoqërohen me shënimin “Prodhuar në përgjegjësinë ligjore” dhe vazhdon emri i subjektit zgjedhor. Për këtë arsye Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, më datën 25 prill të vitit 2023, me vendimin numër 414, ka vendosur iu ka lënë afat subjekteve zgjedhore që brenda datës 28 prill 2023 të vendosin në materialet propagandistike të afishuara prej tyre shënimin “Prodhuar në përgjegjësinë ligjore” të subjektet zgjedhor. Me vendimin numër 424, datë 3 maj 2023, Komisioneri, ka konstatuar se materialet e posterëve të partive politike nuk e mbajnë shënimin prodhuar në përgjegjësinë ligjore të subjektit zgjedhor. Referuar pikave 51 dhe 78 të Kodit Zgjedhor për zbatimin e këtij vendimi janë ngarkuar policitë bashkiake dhe Policia e Shtetit dhe drejtuesit e Policisë Bashkiake dhe Policisë së Shtetit, të cilët duhet të kishin detyrimin të raportonin brenda datës 5 maj 2023 ora 24:00 në lidhje me zbatimin e urdhrin të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Konstatohet se brenda afatit të përcaktuar nga Komisioneri datën 5 maj 2023, policitë bashkiake, përveç 4 policive bashkiake, nga 61 polici, përveç Policisë Bashkiake: Kurbin, Tiranë, Shijak dhe Dimal, policitë e tjera nuk kanë raportuar sipas udhëzimit të Komisionerit. Në këto kushte, referuar

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.15.05.2023*

edhe nenit 171, pika 1 e Kodit Zgjedhor, Komisioneri i ka propozuar KAS-it marrjen e masave administrative në vlerën 5 mijë lekë për të gjithë drejtuesit e policive bashkiake, 57 drejtuesit, të cilët nuk kanë respektuar urdhërimet e bëra në vendimet Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Faleminderit!

Z. K. Bele: Pra, 4 i kanë dorëzuar.

Z.Y. Merkaj: 4 i kanë dorëzuar brenda afatit të caktuar.

Z. K. Bele: Po, por nuk e kuptova. Pra, u është dërguar njoftim 61 bashkive dhe 4 kanë raportuar?

Z. Y. Merkaj: U është dërguar 61 bashkive dhe Policive bashkiakë urdhri i Komisionerit për zbatim. Dhe është një afat për të raportuar që u zbatuan, por nuk u zbatuan. 4 kanë raportuar zbatimin.

Z. K. Bele: Po si e krijuat bindjen që njëri nga këta 55 e ka zbatuar, por nuk ka raportuar, sepse ne nuk i gjobisim për mosraportim, ne i gjobisim për moszbatim. Fakti që ai nuk ka kthyer përgjigje, a barazohet me moszbatimin? Këtë nuk e kuptoj dot.

(Diskutime pa mikrofon)

Z. Y. Merkaj: Kemi komunikuar, nuk e kanë zbatuar.

Z. K. Bele: Po këta të tjerët që e kanë sjellë më datën 15?

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*

 3

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.15.05.2023*

Z. Y. Merkaj: Këta e kanë sjellë me datën 15 maj.

Z. K. Bele: Kjo duhet relatuar, se ata thonë e kemi bërë, mendoj unë.

Z. E. Çefa: Zoti Merkaj, sa raste janë që e kanë relatuar sot nga Policitë Bashkiake?

Z. Y. Merkaj: Janë 7 raste: Policia Bashkiake e Matit, Beratit, Rrogozhinës, Peqin, Pukë, Fier dhe Elbasan.

Z. K. Bele: Po monitoruesit tanë, a kanë feedback, për këto raste, përveç mosraportimit? Sepse marr shkas dhe nga shqyrtimi që patëm me disa raste që u konstatuat dhe e pranoi dhe KAS-i që në aksin Tiranë, Lushnjë, Fier ishin vendosur tabelat, ishin vendosur shiritat. Ndoshta dhe në Bashkinë e Pukës, po them, janë vendosur, por nuk është kthyer përgjigje, pra është mjaftuar me zbatimin e urdhit, por nuk kanë raportuar. Si e përjashtojmë ne këtë rrethanë?

Z. Y. Merkaj: Atëherë, së pari, ne jemi nisur nga mosraportimi, së dyti, janë bërë verifikimet. Dhe deri më datën 5 maj, në orën 24:00 asnjë nga këto Polici Bashkiake nuk e kishin zbatuar vendimin e Komisionerit. Vendimi i Komisionerit është zbatuar më datën 11.05.2023 nga këto 6-7 bashki që citova më lart.

(Diskutime pa mikrofon)

Z. K. Bele: Siç është rasti i Elbasanit, që ne e pushuam atë.

Z. Y. Merkaj: Ne e kemi dhe përgjigjen e Policisë Bashkiake të Elbasanit.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.15.05.2023*

Z. E. Çefa: Unë kam edhe një pyetje tjetër: Konstatojmë se bashkëlidhur vendimit të Komisionerit është edhe lista, pra është jo lista e personave të sanksionuar, pra me emër dhe mbiemër, pra nuk janë të identifikuar personat, por janë të identifikuar thjesht në cilësinë e tyre si drejtues i policisë bashkiake filan. Nuk e di nëse kjo është e mjaftueshme në këndvështrim edhe të Kodit të Procedurës Administrative që ne ta sanksionojmë, ne t'i sanksionojmë këto persona po i njoftuar nominalisht dhe individualisht, që ndaj tyre ka filluar një procedim, në mënyrë që t'i japim mundësi edhe të mbrohen dhe të paraqesin kërkesa, të shpjegojnë situatën si është. Pra, në këtë mënyrë, si është hartuar dhe njoftimi i Komisionerit, është pak gri situata. Ne jemi në vështirësi për të specifikuar përgjegjësinë administrative të gjithsecilit, mendoj unë. Nuk e di a i keni këto emrat, apo kështu keni vepruar me listë?

Z. Y. Merkaç: Është e drejtë kjo që thoni ju.

Z. L. Braho: A kemi procedurë ne për ta kthyer mbrapsht që ta plotësojnë?

Z. I. Rusmali: Unë kam një mendim tjetër nëse do të shkojmë më tutje, pra, sa detyrues është urdhri i Komisionerit për këta që janë të një sistemi tjetër. Sepse urdhri i Komisionerit po i kërkon që sipas ligjit të bëjnë këtë veprim dhe të vetëraportojnë. Kjo të raportojnë a është e detyrueshme për ta?

Z. E. Çefa: Pra, sanksioni të vendoset për mosraportim apo për moszbatim urdhri?

Z. I. Rusmali: Këta konstatojnë mosraportimin dhe nënkuptojnë që nuk është zbatuar. Dhe ky është prezumim që e bëjnë këta. Fakti është që...

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*

P. Braho 5

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.15.05.2023*

Z. E. Çefa: A kanë feedback monitoruesit?

Z. K. Bele: Në terma logjike mund të jetë që ai që nuk ka thënë e bëra dhe po nga ana tjetër ata, në ditët e fushatës, dikush mund ta ketë bërë dhe nuk ka kthyer përgjigje. Ne nuk e përjashtojmë dot.

Z. I. Rusmali: Ky është një kazus që ju duhet ta studioni më mirë, them unë nga zbatueshmëria ligjore, sepse, nëse niseni nga premisa që i lëshoni një urdhër, po nuk e zbatuan, ne i kërcasim gjobën dhe gjoba është detyrimi për ta, kjo është premisë e gabuar. Ata e kanë detyrimin të zbatimit të ligjit. A ka një dispozitë ligjore që i detyron ata që të bëjnë këto veprime? Nëse nuk ka dispozita ligjore duhet krijuar. Minimumi më minimalja me mjetet që keni ju është një marrëveshje me Ministrinë e Brendshme, me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë që të jetë akt që ta parashikojë këtë detyrimin e tyre për raportim dhe në bazë të atij akti ju mund t'i kërkonit llogari. Por sa kohë që e keni të pastudiuar ligjërisht, së pari, dhe së dyti, të paidentifikuara subjektet, dhe kjo që thotë Elvisi është thelbësore, ju nuk zbatoni dot Kodin e Procedurës Administrative, nuk garantoni dot të drejtat procedurale. Kështu që unë...

Z. E. Çefa: Atëherë, pyetje të tjera nga kolegët nuk ka. Përfundimisht do të kalojmë në konkluzione. Zoti Merkaj, definitivisht do t'i qëndroni vendimit të Komisionerit, apo?

Z. Y. Merkaj: Duke qenë që, siç u diskutua dhe këtu, emrat nuk janë, janë vetëm emrat e drejtuesve të Policisë Bashkiake, por, përgjegjësia është individuale, mendoj që të kërkojmë kohë, t'ju pasurojmë kërkesën me emra konkretë.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.15.05.2023*

Z. I. Rusmali: Dakord. Ju tërhiqeni kërkesën, të mund ta ribëni prapë, nuk ka asnjë pengesë, pasi ta keni kompletuar. Por na jepni ne që ta proceduralisht ta mbyllim këtë çështje dhe pastaj kur të doni e hapim prapë, sepse ta lëmë pezull nuk ka sens.

Z. L. Braho: Mund të merrni informacion dhe nga monitoruesit, për çfarë është zbatuar dhe çfarë jo gjatë kësaj.

Z. K. Bele: Merrni dhe kohën e nevojshme se këto dy - tri ditë është e kuptueshme që jeni fokusuar te...

Z. I. Rusmali: Nuk na rri ne, pra shqyrtim pezull te ne nuk ka, ka ose pushim ose pranim, ose rrëzim, ose ndryshim.

Z. L. Braho: Mund të bëjmë pezullimin e shqyrtimit administrativ deri sa këta të plotësojnë këto.

Z. I. Rusmali: Ka thënë Kolegji?

Z. L. Braho: Po.

Z. K. Bele: A kemi procedurë të kthejmë dosjen për plotësim?

Z. L. Braho: Jo.

Z. Y. Merkaj: Afatet kanë qenë shumë të shkurtra.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.15.05.2023*

Z. I. Rusmali: Ne i kemi kthyer për hetim dhe këta nuk kanë bërë hetim.

Z. K. Belev: Kjo është tjetër gjë.

Z. L. Braho: Unë them se ajo nuk ecën proceduralisht me Kod Procedure. Nuk e njeh Kodi i Procedurës kthimin për organin epror.

Z. I. Rusmali: Pse e doni ju pezullimin? Ty për çfarë të duhet pezullimi?

Z. Y. Merkaj: Nuk dua pezullimin, dua shtyrjen e afatit deri sa të plotësohet me emrat....

Z. I. Rusmali: Po, shtyrja e afatit pezullimi shqyrtimit. Ti nuk ke asnjë pengesë ligjore nëse ti e tërheq. Ne e mbyllim dhe e hapim prapë pas një jave. A ke pengesë ligjore?

Z. L. Braho: Duhet të bëjë vendim prapë Komisioneri.

Z. E. Çefa: Po.

Z. I. Rusmali: Po do ta bëjë se nuk bën, do të japë emrat në vendim. Do ta kërkojë me emra të përveçëm.

Z. E. Çefa: Me këtë vendim nuk shkon, do të bëjë një vendim të ri, do të bëjë një procedurë krejt të re.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.15.05.2023*

Z. L. Braho: Për mua duhet bërë dhe kjo që të kesh raport nga monitoruesi që gjobat, nëse do t'i vëmë, do t'i vëmë për moszbatim urdhri jo për mosraportim, sepse edhe 79-ta edhe udhëzimi juaj nuk thotë ndonjë detyrim për raportim.

Z. E. Çefa: Atëherë, nëse ne e rrëzojmë, do të gjykohet si...

Z. L. Braho: E gjykuar.

Z. E. Çefa: Nëse këta e tërheqin, atëherë ne e pushojmë dhe e riçelim në një moment të dytë. Dakord? Pra, përfundimisht kërkoni pushimin e vendimit administrativ?

Z. Y. Merkaç: Po.

Z. E. Çefa: KAS-i tërhiqet për vendim. Kolegë, a jeni dakord?

KAS-i pasi diskutoi çështjen në tërësi vendosi pranimin e kërkesës së sekretarit të Përgjithshëm për pushimin e këtij procedimi administrativ në mënyrë që Komisioneri të ketë mundësinë ta rifillojë tashmë në kushte reja, duke e plotësuar atë më mirë me elementet e tjerë për sanksionimin e personave përgjegjës. Me kaq seanca deklarohet e mbyllur. Faleminderit!

Vendimi nr. 112

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.15.05.2023*

15.05.2023
Ora 12.51

RENDI I DITËS

Shqyrtimi i kërkesës nr. 29 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me objekt
“Vendosje të sanksioneve administrative”.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, znj. I. Osmanaj, z. E. Mema.
- **Të tjerë:**

Z. I. Rusmali: Çelim seancën për shqyrtimin e kërkesës nr. 29 të Komisionerit për vendosje sanksioni administrativ ndaj një numri prej 13 kryetarësh bashkie në detyrë. Janë njoftuar?

Z. Y. Merkaj: Po.

Z. I. Rusmali: Janë njoftuar, por nuk është asnjëri prezent. KAS-i është në përbërje të plotë, sekretari i Përgjithshëm me ekipin e tij është i pranishëm. Ia japim fjalën sekretarit të Përgjithshëm për të bërë prezantimin e kërkesës.

Z. Y. Merkaj: Faleminderit! Referuar nenit 79, pika 1, të Kodit Zgjedhor, kryetarët e bashkive ka detyrimin jo më vonë se 35 ditë përpara ditës së zgjedhjeve të

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.15.05.2023*

përcaktojnë vendet publike në territorin e bashkisë përkatëse për afishimin prej partive politike dhe subjekteve zgjedhore të materialeve propagandistike. Në datën 24 prill 2023 Komisioneri u është drejtuar të gjitha bashkive për përcaktimin e vendeve publike në territorin në juridiksionin e tyre për afishimin e materialeve propagandistike. Në zbatim të udhëzimit nr. 6 të vitit 2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për përdorimin e materialeve propagandistike dhe edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore, bashkitë kanë detyrimin të dorëzojnë vendimin e tyre në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ku janë përcaktuar edhe vendet publike për afishim të materialeve propagandistike. Nga informacioni i administruar, rezulton se 13 bashki nuk kanë dorëzuar vendimet për afishimet përkatëse për materialet propagandistike në vendet përkatëse. Në këto kushte, Komisioneri ka vlerësuar se 13 kryetarët e bashkive kanë shkelur dispozitat e Kodit Zgjedhor dhe në bazë të nenit 171, pika 1 e Kodit Zgjedhor, i propozon KAS-it marrjen e masave administratave për 13 kryetarët e bashkive në vlerën 5 mijë lekë. Konkretisht: Fran Tuci, kryetar i Bashkisë Fushë Arrëz; Andis Salla, kryetar i Bashkisë Cërrik; Safet Gjici, kryetar i Bashkisë Kukës; Majlinda Qilimi, kryetare e Bashkisë Delvinë; Adem Lala, kryetar i Bashkisë Has; Luiza Mandi, kryetare e Bashkisë Libohovë; Elton Arbana kryetar i Bashkisë Shijak; Dritan Leli, kryetar i Bashkisë Vlorë; Kreshnik Hajdari, kryetar i Bashkisë Kuçovë; Bardh Spahia, kryetar i Bashkisë Shkodër, Mark Babani, kryetar i Bashkisë së Vaut të Dejë; Eduard Duro, kryetar i Bashkisë Devoll dhe Fredi Kokoneshi, kryetar i Bashkisë Divjakë.

Z. I. Rusmali: Faleminderit! Ka pyetje nga kolegët? Nuk ka. Edhe në këtë rast jemi përpara së njëjtës pyetje: ata nuk kanë raportuar që kanë plotësuar detyrimin ligjor.

Z. Y. Merkaj: Jo, nuk është raportim. Ata duhet të dorëzojnë në KQZ vendimet.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.15.05.2023*

Z. I. Rusmali: Kjo vjen nga ligji apo...?

Z. Y. Merkaj: Nga udhëzimi numër 6.

Z. I. Rusmali: Nga ligji vjen detyrimi që duhet të përcaktojnë...

Z. Y. Merkaj: 35 ditë para vendet publike për afishimin e materialeve.

Z. I. Rusmali: Pavarësisht nëse kanë depozituar ose jo në KQZ, keni bërë verifikim?

Z. Y. Merkaj: E kemi bërë verifikimin dhe nuk i kanë sjellë dhe Komisioneri u ka kërkuar edhe informacion dhe u ka thënë që duhet të dorëzojnë vendimet.

Z. I. Rusmali: Jo verifikim në dosjen tuaj. Keni bërë verifikim e kanë përcaktuar afishimin?

Z. Y. Merkaj: U kemi thënë kryetarëve të bashkive që duhet të na sjellin vendimet.

Z. I. Rusmali: Ata thjesht e kanë injoruar detyrimin.

Z. Y. Merkaj: Nga monitorimi është verifikuar që nuk janë përcaktuar vendet publike.

Z. I. Rusmali: Pyetje tjetër?

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.15.05.2023*

Z. L. Braho: Unë kisha një pyetje për masën e gjobës. Shkelja duket e rëndë për zgjedhjet, kështu që pse vendoset gjoba 5 mijë lekë dhe jo pak më shumë?

Z. Y. Merkaj: Varet, ajo është subjektive. Komisioni ka menduar që në proporcion me shkeljen...

Z. L. Braho: Ndonjë nga këta është gjobitur më parë?

Z. Y. Merkaj: Jo.

Z. L. Braho: Andis Salla.

Z. I. Rusmali: Për këtë gjë jo.

Z. Y. Merkaj: Nuk është për njëjtën gjë.

Z. L. Braho: Nuk është recidivist i posaçëm, por i përgjithshëm.

Z. I. Rusmali: Masën e gjobës e diskutojmë pastaj. Dakord. Pyetje nuk ka. Kërkimi juaj përfundimisht është të pranohet kërkesa.

Z. Y. Merkaj: Pranimi i kërkesës së Komisionerit për vendosje sanksionesh administrative.

Z. I. Rusmali: Mbyllim këtu shqyrtimin dhe tërhiqemi për të marrë vendim.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.15.05.2023*

Rifillon

Ora 12.59

Z. I. Rusmali: Riçelim seancën për të bërë shpalljen e vendimit lidhur me kërkesën e Komisionerit nr. 29. KAS-i, pasi e shqyrtoi në tërësi çështjen, vendosi:

- pranimin e kërkesës, vendosjen e sanksionit administrativ, gjobë në vlerën 5 mijë lekë për kryetarët e bashkive në detyrë: zotin Fran Tuci, Fushë Arrëz; zotin Andis Salla, Cërrik; zotin Safet Gjici, Kukës; zonjën Majlinda Qilimi, Delvinë; zotin Adem Lala, Has; zonjën Luiza Mandi, Libohovë; zotin Elton Arbana, Shijak; zotin Dritan Leli, Vlorë; zotin Kreshnik Hajdari, Kuçovë; zotin Bardh Spahia, Shkodër, zotin Mark Babani, Vau i Dejës; zotin Eduard Duro, Devoll dhe zotin Fredi Kokoneshi, Divjakë.

- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.


- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë brenda 45 ditëve nga njoftimi i tij.

- Ngarkohet administrata e KQZ-së të bëjë njoftimin e palëve në mungesë e të zbatojë këtë vendim.

Me kaq seanca deklarohet e mbyllur.

Vendimi nr. 113

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*

 5

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.15.05.2023*

**15.05.2023
Ora 13.01**

RENDI I DITËS

**Shqyrtimi i kërkesës nr. 30 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me objekt
“Vendosje të sanksioneve administrative”**

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, znj. I. Osmanaj, z. E. Mema
- **Të tjerë:** Z. Enea Hoti (Ministria e Brendshme)

Z. E. Lako: Çelim seancën për shqyrtimin në themel të çështjes, pra të kërkesës nr. 30, të depozituar në datën 12.5.2023 nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me objekt: kërkesë për vendosje sanksioni administrativ në vlerën 3 mijë lekë ndaj disa personave përgjegjës në Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjen Sociale, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Shtetit për Standardet dhe Shërbimet dhe Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme. Relator i kësaj çështjeje jam zgjedhur unë Elvin Lako. Para se të fillojmë me shqyrtimin e çështjes, verifikojmë palët pjesëmarrëse. Janë njoftuar palët e interesuara? Kanë dijeni dhe nuk marrin pjesë. Vazhdojmë edhe në mungesë të tyre. Është prezent trupa e KAS-it e përbërë nga pesë anëtarë. Është gjithashtu edhe administrata, e përfaqësuar nga sekretari i Përgjithshëm. Palë të interesuara nuk ka. Shkurtimisht, zoti sekretar i Përgjithshëm në lidhje e këtë kërkesë përse është propozuar nga Komisioneri sanksionimi i këtyre personave.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.15.05.2023*

Z. Y. Merkaç: Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është depozituar denoncimi se institucionet publike, si ministri e ministra kanë publikuar postime apo kanë ripostuar të dhëna me përmbajtje partiake në faqen zyrtare të rrjetit të tyre social *facebook*, të cilat përbëjnë përdorim të burimeve publike. Subjektet e denoncuarra janë 6 ministri dhe 14 ministra. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, duke parë dhe duke shqyrtuar paraprakisht çështjen, ka vlerësuar se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ, ka nisur hetimin administrativ. Gjatë hetimit administrativ është pretenduar se në aktivitetin e hapjes së fushatës elektorale nga Partia Socialiste më 11 prill 2023, kjo e fundit ka bërë publike edhe sloganin e fushatës elektorale të zgjedhjeve të datës 14 maj 2023 e konkretisht slogani i fushatës është: “Vetëm përpara, kurrë mbrapa”. KRIIK ka vërejtur që këto slogane shoqërojnë çdo postim dhe, pavarësisht se ato janë me natyrë institucionale, në faqen zyrtare të rrjetit social *facebook* të Kryeministrit, të ministrave, deputetëve dhe kryetarëve të bashkive, të cilët kanë llogari aktive në rrjetet sociale, i kanë konvertuar dhe i kanë përdorur edhe si hashtag dhe lidhen e identifikojnë drejtpërdrejt subjektin zgjedhor Partia Socialiste. Në përfundim të shqyrtimit administrativ për denoncimet e regjistruara, si dhe pas administrimit të provave, është provuar se të gjitha postimet dhe ripostimet në faqen zyrtare të rrjetit social *facebook* të institucioneve, subjekt i këtij denoncimi, janë përdorur hashtag dhe slogane me përmbajtje elektorale. Neni 91, pika 1, i Kodit Zgjedhor përcakton se nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor. Vënia në dispozicion e faqeve zyrtare në *facebook* apo çdo mjeti tjetër komunikimi elektronik, media sociale të institucioneve publike për publikimin e postimeve apo nëpërmjet ripostimit të postimeve që përmbajnë hashtag, slogane me karakter politik elektoral në zgjedhje apo thirrje për mbështetje në zgjedhje nga

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.15.05.2023*

ana e këtyre institucione përbën përdorim të burimeve publike. Në këto kushte, kur institucionet publike, si: Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjen Sociale, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Shtetit për Standardet dhe Shërbimet kanë bërë një sërë ripostimesh, të cilat përmbajnë hashtage dhe slogane me karakter elektorale, duke keqpërdorur këto llogari institucionale, që përbëjnë burim publik. Në këto kushte, duke qenë se përgjegjësit për mirëmbajtjen dhe postimin e këtyre kanë qenë sekretarët e Përgjithshëm, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, duke konstatuar që përbëjnë shkelje të nenit 91 të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9 të Komisionit Rregullator, ka vendosur t'i propozojë KAS-it marrjen e masave administrative në vlerën 3 mijë lekë për personin përgjegjës në Ministrinë e Brendshme, Enea Hoti; personin përgjegjës në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjen Sociale, zonjën Joana Duro; personin përgjegjës në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, zonjën Risena Xhaja; personin përgjegjës pranë Ministrisë së Shtetit për Standardet dhe Shërbimet, zonjën Edlira Zyfi dhe personin përgjegjës në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme, zotin Gazmend Turdiu. Në këto kushte kërkojmë pranimin e kërkesës së Komisionierit për vendosjen e masave administrative. Faleminderit!

Z. E. Lako: Faleminderit, zoti Merkaj! Nga këto provat që keni paraqitur në dosje, unë shoh fotografitë e faqeve të *facebook*-ut dhe pak a shumë të gjitha postimet janë me natyrë të punëve të përditshme të institucioneve. E vetmja gjë, edhe ajo që përmendët ju, është ky hashtagu në fund “Vetëm përpara, kurrë më mbrapa”. Ju keni bërë hetim që kjo mos është ndonjë formulë e dhënë me urdhër që të gjithë ta kenë këtë, se e kanë pothuajse njësoj të gjitha faqet e institucioneve të ndryshme, nuk është se e ka bërë njëri e tjetri nuk e ka bërë.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.15.05.2023*

Z. Y. Merkaaj: Mund të jetë edhe me urdhër.

Z. E. Lako: Ia kanë vënë te faqja dhe çfarëdo që të postojnë, del aty kjo.

Z. I. Osmanaj: Është një slogan që identifikon një subjekt zgjedhor dhe si rrjedhojë...

Z. E. Lako: Nuk po i hyj asaj, po i hyj përgjegjësisë së personit që e ka publikuar. Ai mundet që të jetë vënë aty, si puna e imeilit, se ajo sigël është dhe del automatikisht. Po t'i shohësh, ato janë njësoj. Mos janë automatikisht? E keni hetuar përgjegjësinë e personit vetë?

Z. Y. Merkaaj: E kemi hetuar. Individin nuk e përjashton nga përgjegjësia penale.

Z. E. Lako: Nuk ka lidhje fare kjo që po pyes unë me...

Z. Y. Merkaaj: Personi përgjegjës përgjigjet për faqen dhe është i detyruar e duhet të dijë që këto janë slogane të një subjekti zgjedhor.

Z. E. Lako: Nuk po pyes a kishte dijeni personi apo janë apo jo. Mos kanë bërë ndonjë program, se këto janë të gjitha identike, mënyra sesi vendoset kjo fjalia në fund.

Z. Y. Merkaaj: I nderuar zoti anëtar i KAS-it, nuk mund t'i përgjigjem kësaj pyetjeje.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.15.05.2023*

Z. L. Braho: Ta thelloj unë pak pyetjen. Mos ka ndonjë urdhër nga sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave që të vendoset kjo?

Z. K. Bele: Nuk mund të bëjmë hipoteza. Ata nuk marrin urdhër nga qeveria për këto gjëra, mendoj unë.

Z. E. Lako: Po, zoti Rusmali.

Z. I. Rusmali: Kur është shqyrtuar ky denoncim?

Znj. I. Osmanaj: Ky denoncim është shqyrtuar në datën 11.05.2023.

Z. I. Rusmali: Në datën e shqyrtimit ju keni...

Znj. I. Osmanaj: Ne kemi konstatuar që po në datën e shqyrtimit janë bërë *screen shot* të gjitha postimet në faqen zyrtare të këtyre institucioneve, pra të gjitha këto prova që ju keni aktualisht janë të datës 11.05.2023.

Z. I. Rusmali: Dakord, një pjesë e postimeve janë mbas datës 14.

Z. K. Bele: Unë shoh që postimet janë të vjetra, më falni!

Z. I. Rusmali: Një pjesë janë më të vjetra, një pjesë janë kështu. Për shembull, Ministria për Europën e ka një postim në datën 19 prill.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.15.05.2023*

Z. K. Bele: Unë kam një merak tjetër, në shtesë të kësaj që ngriti Iliriani. Për shembull, shoh Ministrinë e Shëndetësisë (nuk e shoh datën këtu), 2 ditë para, thotë kjo, çështja është se këto gjëra, ne për të njëjtën shkelje i kemi sanksionuar një...

Znj. I. Osmanaj: Çështja është se janë postime të ndryshme, nuk është i njëjti postim që ju mund të keni sanksionuar një herë, këto janë postime të ndryshme, që ju vijnë sot për herë të parë. Nuk është i njëjti postim.

Z. K. Bele: Se kjo e rritjes së pagave është e hershme.

Z. E. Lako: Datat e postimeve ku dalin këtu.

Z. I. Rusmali: Datat e postimeve janë aty. Ky thotë ne e kemi printuar në datën 11 maj këtë.

Z. E. Lako: Kështu që katër ditë i bie nga printimi.

Z. Y. Merkaj: Domethënë në qoftë se vjedh një person e dënojmë dhe vjedh për herë të dytë, ne nuk e dallojmë?

Z. K. Bele: Jo të mos e dënojmë për të njëjtën shkelje.

(Diskutime pa mikrofon)

Znj. I. Osmanaj: Për aq kohë sa subjekti zgjedhor nuk është vënë në dijeni të këtij fakti, e kemi përjashtuar nga përgjegjësia dhe nuk ka marrë dijeni për këtë gjë.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.15.05.2023*

Z. I. Rusmali: Dakord.

Z. E. Lako: Mirë, ka pyetje të tjera?

Z. I. Rusmali: Edhe një të fundit. Identifikimi i përgjegjesisë administrative te sekretari i Përgjithshëm vjen në bazë të vendimit nr. 9, apo jo, sepse aty i është përcaktuar detyrimi i atij që gjithmonë të kujdeset që të mos ketë...

Znj. I. Osmanaj: Është sekretari i Përgjithshëm ose drejtori i Përgjithshëm.

Z. I. Rusmali: Në rastin e ministrive është te sekretari i Përgjithshëm. Dakord. Ndonjë arsyetim për propozimin e masës 3 mijë lekë. Si e keni gjykuar, pse 3 mijë lekë?

Z. E. Lako: 2 e kanë për herë të parë a 3, 2 janë përsëritës, thoni ju.

Z. Y. Merkaj: Unë thashë që është subjektive, Komisioneri ka vlerësuar...

Z. I. Rusmali: Dakord, subjektive është, po ka një logjikë.

Znj. I. Osmanaj: Nuk është përcaktuar si shkelje e rëndë.

Z. L. Braho: Ligji për kundërvajtjen administrative e parashikon.

Z. I. Rusmali: Ju mund të thoni që e kemi me kokë a pil, mund të thoni e hedhim masën me short, është procedurë,

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.15.05.2023*

Z. Y. Merkaç: Komisioneri ka vendosur masën më të butë për këta persona.

Z. I. Rusmali: Sepse e gjykon që është e mjaftueshme, 3 mijë lekë, është e mjaftueshme për të edukuar sekretarin e Përgjithshëm.

Znj. I. Osmanaj: Sepse një pjesë e mirë e institucioneve janë ndërgjegjësuar dhe përveçse po fshijnë të gjitha ripostimet, po mbyllin edhe faqet. Domethënë kemi konstatuar që, për shembull, disa bashki e kanë mbyllur fare faqen e *facebook*-ut.

Z. K. Bele: Po arrihet jo vetëm parandalimi, po edhe qëllimi i edukimit.

Znj. I. Osmanaj: Ndërgjegjësimit.

Z. E. Lako: Nëse nuk ka pyetje tjetër, pra ju kërkoni nga KAS-i pranimin e kërkesës dhe vendosjen e këtyre gjobave. Faleminderit! Do të mblidhemi për 5 minuta dhe do të shpallim vendimin.

Rifillon seanca

Ora 13:15

Z. E. Lako: Atëherë meqenëse ne e filluam seancën pak përpara orarit të caktuar dhe personat e interesuar janë paraqitur, e çelim edhe një herë seancën, në mënyrë që edhe personat për të cilët po shqyrtohet në këtë hetim administrativ të kenë mundësi të thonë mendimin dhe opinionin e tyre. Pra, shkurtimisht ju, zoti Enea Hoti.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*

 8

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.15.05.2023*

Z. E. Hoti: Unë jam Enea Hoti, sekretari i Përgjithshëm ose personi përgjegjës i ngarkuar nga legjislacioni përkatës.

Z. E. Lako: Atëherë, ne po shqyrtonim këtë hetim administrativ. U relatua nga sekretari i Përgjithshëm se cilat janë shkeljet e pretenduara nga ana e administratës dhe e Komisionerit për postimet dhe ripostimet në faqen zyrtare të institucionit, që kanë karakter elektorale dhe bien ndesh me vendimin e Komisionit Rregullator nr. 9, kështu që ju besoj jeni në dijeni se çfarë është pretenduar gjatë hetimit administrativ nga Komisioneri, kështu që para KAS-it mund të na thoni shkurtimisht se pse ju e kundërshtoni këtë masë të propozuar.

Z. I. Rusmali: Jo, ata mund të jenë dakord, të shohim se çfarë kanë për të thënë.

Z. E. Lako: Nuk janë dakord, se e shprehu. Po, zoti Hoti.

Z. E. Hoti: Faleminderit, që më dhatë kohën! Atëherë, dua paraprakisht të them që Ministria e Brendshme i ka kushtuar një vëmendje të veçantë respektimit të legjislacionit, për sa i përket zbatimit dhe mosthyerjes së rregullave që vendos Kodi Zgjedhor, sidomos me postimet në *facebook* dhe po të shikohet deri në datën e shkeljes së pretenduar, Ministria e Brendshme e ka respektuar shumë ligjin, s'kemi pasur problematika të tilla. Eventuallë apo ngjarja që ka ndodhur, shkelja e pretenduar, ka qenë një event i Ministrisë së Brendshme nuk ka qenë një event elektorale. Ka qenë ditë e shtunë dhe kuptohet që ditën e shtunë administrata dhe operatorët që merren me faqen nuk janë në punë, por gjithsesi roli i sekretarit të Përgjithshëm, si mbikëqyrës i administratës, i jep detyrën që të mbikëqyrë administratën dhe në momentin që vë re shkelje apo gabime të marrë masa ndaj personave që kryejnë

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*

 9

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.15.05.2023*

shkeljen. Kuptohet nuk është se sekretari i Përgjithshëm mban ose operon me *facebook* –un, kështu që pavarësisht se ka qenë ditë e shtunë, që në momentin që sekretari i Përgjithshëm ka konstatuar se ka një postim me përmbajtje, po themi, jo sipas rregullave të përcaktuara, menjëherë kemi vepruar dhe e kemi tërhequr materialin dhe e kemi diversifikuar burimin dhe kemi marrë masat që të mos ketë pasoja për më vonë. Kështu që edhe sot po ta konstatojmë, ato janë postime të hequra dhe nuk gjenden. Kështu që duke marrë parasysh këto rrethana të një gabimi teknik dhe material, duke qenë se ka qenë edhe ditë e shtunë dhe administrata, operatorët përgjegjës nuk kanë qenë shumë mirë të trajnuar, sekretari i Përgjithshëm sapo ka marrë dijeni menjëherë e kemi korrigjuar dhe impakti nuk ka qenë, po themi. Kështu që në këto rrethana do të kërkoja që të rishqyrtohet shkelja dhe të merrej parasysh kundërshtimi.

Z. E. Lako: Faleminderit, zoti Hoti! Është radha e Komisionit që të bëjë pyetje. Meqë unë jam relatori, po ju bëj një pyetje shkurtimisht, se ne i shqyrtuam disa nga provat e paraqitura dhe kemi vërejtur, për shembull, që në rastin e Ministrisë së Brendshme është ky postim këtu, që konstatuam që aktiviteti është i ligjshëm, sepse nuk është me karakter elektoral, por e vetmja gjë që kanë pothuajse të gjitha postimet është ky hashtag në fund: “Vetëm përpara, kurrë më mbrapa”, dhe ky është shkaku që pothuajse të gjitha këto postime janë konsideruar me karakter elektoral. Çfarë mund të na thoni për këtë?

Z. E. Hoti: I vetmi burim nga të cili ne merrnim po themi *feed-in* të personit politik në fjalë, që ata e kanë lirinë e tyre, që mund të shprehen dhe e kemi pasur të pamundur teknikisht që të diversifikonim burimin e *share-it*, po menjëherë sapo është konstatuar është...

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*

 10

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.15.05.2023*

Z. E. Lako: Domethënë, ky postim është ripostim dhe nuk mund të hiqej kjo. Pra nuk është se është vendosur nga ju. Ky është argumenti.

Z. E. Hoti: Jo, në asnjë mënyrë, ky është argumenti.

Z. E. Lako: Çfarë keni për të thënë, zoti Ylli, meqenëse kjo gjë duhet të këtë dalë nga hetimi, sepse unë për këtë ju pyeta? Pak a shumë, të gjitha postimet duken sikur janë bërë nga një dorë, nuk është postim, për shembull, i Ministrisë së Brendshme apo i dikujt tjetër, por këto janë ripostime, që janë marrë nga burimi. Pra, dakord, që është një postim i Ministrisë së Brendshme, por kompozimi, le të themi, është i atij që ka bërë postimin. Domethënë, është hetuar kjo, apo si ka dalë përgjegjësia?

Z. Y. Merkaj: Është hetuar. Përgjegjësia e personit përgjegjës, në qoftë se ka slogane që kanë përmbajtje elektorale të një subjekti zgjedhor, siç janë e sloganet e përdorura, është e ndaluar.

Z. E. Hoti: Ne kemi reaguar menjëherë.

Z. Y. Merkaj: Në momentin që është bërë shqyrtimi, këto kanë qenë në faqe.

Z. K. Bele: Një gjë nuk kuptova drejt nga ajo që shpjeguat ju. Ju po thoni që personat e IT-së, të cilët bëjnë gjithnjë ripostimet e aktiviteteve politike, nuk kanë kuptuar hashtagun, i cili bën diferencë nga një aktivet politik i Kryeministrit, ministrit apo i zëvendëskryeministrit, dhe ajo që juve ju ka vendosur në këtë pozitë është qenia e hashtgut në këto ripostime apo ka postime origjinale?

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.15.05.2023*

Z. Y. Merkaj: Ripostime.

Z. E. Hoti: Ka qenë ditë e shtunë dhe personi që merret zakonisht me këto e ka pasur ditë pushimi.

Z. K. Bele: Pra, ka qenë një veprim ritunor i pa..

Z. E. Hoti: Ndërkohë që unë si sekretar i Përgjithshëm, që e ngarkon ligji, besoj që e kam kryer detyrën me përpikëri, sepse, sapo është konstatuar, kam marrë masat dhe kemi reaguar. Jemi përpjekur të ulim në maksimum pasojat.

Z. L. Braho: Sa ditë ka ndenjtur e ripostuar kjo?

Znj. I. Osmanaj: Deri në datën e shqyrtimit, pra që është data 11.5, kjo ka qenë e postuar.

Z. L. Braho: Kur është bërë ripostimi, e ke datën aty? Katër ditë para.

Z. E. Hoti: Ka qenë ditë e shtunë, gjysmë ore aktivitet në Vlorë për shkak të fillimit të sezonit.

Z. L. Braho: Kjo është ripostim që në momentin që ka qenë *live*?

Z. E. Hoti: Po, pra. Nuk është se ka ngelur në faqe.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.15.05.2023*

Z. E. Lako: Po se edhe mua më bëri përshtypje mënyra sesi janë kompozuar gjithë këto. Duket që është një dore, nuk është se ..

Z. L. Braho: Duket që është ripostim, por problemi është a ka ndonjë detyrim Ministria Brendshme të bëjë ripostime të faqes së Kryeministrit?

Z. E. Hoti: Ka qenë aktivitet i Policisë së Shtetit, event, domethënë...

Z. E. Lako: Ndonjë pyetje tjetër, zoti Rusmali? Jo. Faleminderit! Shkurtimisht edhe një herë; zoti sekretar i Përgjithshëm kërkon lënien në fuqi të kërkesës për vendosjen e masës, ndërsa ju kërkonte rrëzimin e kërkesës. Mirë do të mblidhemi për dy minuta dhe do të shpallim vendimin.


Rifillon seanca

Ora 13:28

Z. E. Lako: Riçelim seancën, në përfundim të hetimit administrativ Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, pasi shqyrtoi kërkesën nr. 30 të Komisionerit dhe faktet e paraqitura vendosi:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës nr. 30 të Komisionerit;
- Vendosjen e sanksionit administrativ në masën 3 000 (tre mijë) lekë ndaj zonjës Joana Duro, person përgjegjës në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; zonjës Risena Xhaja, person përgjegjës në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në masën 3 000 (tre mijë) lekë;
- zonjës Edlira Zyfi, person përgjegjës në Ministrinë e Shtetit për Standardet e Shërbimeve;

**Zbardhi materialin audio
Alma KOLA**

 13

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.15.05.2023*

zotit Gazmend Turdiu, person përgjegjës në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

- Pushimin e procedimit administrativ për pjesën tjetër të kërkesës.
 - Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
 - Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim brenda 45 ditëve nga njoftimi i këtij vendimi, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
- Me kaq e deklarojmë të mbyllur këtë seancë.

Vendimi nr. 114

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 15.05.2023*

**15.05.2023
Ora 14:10**

RENDI I DITËS

**“Shqyrtimi i kërkesës nr. 31, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me objekt
“Vendosje të sanksioneve administrative””.**


PJESËMARRJA:

- **KAS-i:** **Z. Elvin Lako, Z. Ilirjan Rusmali,
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.**
- **Stafi i KQZ-së:** **Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema.**
- **Të tjerë:** **KRIIK**

Z. K. Bele: Çelim seancën në lidhje me kërkesën nr. 31, KAS-i prezent me katër anëtarë. Relator i kërkesës jam unë, Koli Bele. Prezent administrata e KQZ-së, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm. Zoti Ylli, shkurtimisht, dy fjalë në lidhje me kërkesën.

Z. Y. Merkaj: Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve janë regjistruar denoncimet për kryetarin e bashkisë Poliçan, Kamëz dhe Vorë. Kanë postuar në faqen e tyre publikime partiake. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi ka vlerësuar se informacioni, apo pamjet e treguara japin bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ, ka nisur shqyrtimin administrativ. Pretendohet se në aktivitetin e hapjes së fushatës nga Partia Socialiste në datën 11 prill 2023, kjo e fundit bëri

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 15.05.2023*

publike dhe slloganin e fushatës elektorale të zgjedhjeve të datës 14 maj 2023. Konkretisht sllogani i fushatës ishte “Vetëm para, kurrë mbrapa”.

Z. K. Bele: Faleminderit, zoti Merkaj! Pra, jemi në kushtet që vendimi nr. 498, dt. 11 maj, Komisioneri ka pushuar shqyrtimin administrativ për...

Z. Y. Merkaj: Kryetarin e Bashkisë Poliçan...

Z. K. Bele: ... dhe ka konstatuar këto shkelje. Si jemi me njoftimet, janë njoftuar palët?

Z. Y. Merkaj: Po palët janë njoftuar!


Z. K. Bele: Provohet dijenia?

Z. Y. Merkaj: Po! I kemi njoftuar për në orën 14:00, ora është 14:15 dhe ende nuk kanë ardhur.

Z. K. Bele: Pyetja ime ka të bëjë, a janë njoftuar palët për shqyrtimin administrativ para Komisionerit? A i është nisur njoftimi që para Komisionerit po shqyrtohet administrativisht kjo shkelje?

Z. Y. Merkaj: Në çdo shqyrtim të Komisionerit, njoftohet çdo palë që ka interes dhe që u cënohet e drejta e tyre. Njoftimi bëhet me e-mail.

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 15.05.2023*

Z. K. Bele: Pra, ne u dërgojmë një e-mail për njoftimin e tyre.

Z. Y. Merkaç: U njoftohet dita dhe ora e seancës.

Z. K. Bele: Në adresën e tyre zyrtare dhe ju konfirmoni që në këtë rast është kryer njoftimi?

Z. Y. Merkaç: Po, dhe nuk janë paraqitur.

Z. K. Bele: Dakord! Këto janë ripostime?

Z. Y. Merkaç: Po ripostime me slloganin e bashkisë.

Z. K. Bele: Po, i njejti kasus si në të dy rastet e tjera, kërkesa nr. 30 dhe 29 në mos gaboj...


Z. Y. Merkaç: Po, "S"ka kohë për pushim"...

Z. K. Bele: Dakord! Atëhere, në këto kushte, ndonjë pyetje nga kolegët? S'besoj se kanë pyetje, është i njejti kasus.

Z. I. Rusmali: Jo, jo s'kemi pyetje!

Z. K. Bele: Përfundimisht çfarë kërkonti?

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 15.05.2023**

Z. I. Rusmali: Jo me 30!

Z. K. Bele: Dakord jo me 30, e kisha fjalën te ripostimi që nga pikëpamja materiale shkelja e kryer ka të bëjë me ripostimin e gatshëm të aktivitetit të tyre, të ministrit.. në këtë kuptim janë po i quaj “më të lehta”, sepse nuk janë duke bërë propagandën e tyre kryetarët, por kanë kuptuar që e drejta për të ripostuar nuk duhet të këtë filtër në lidhje me çfarë postojnë. Në një kohë që për slloganet, ata kanë qenë në dijeni që nuk duhet t’i ripostonin.

Z. K. Bele: Përfundimisht Ylli, çfarë kërkoni nga KAS-i?


Z. Y. Merhaj: Duke qenë se kanë përdorur postet e tyre të institucionit dhe kanë keqpërdorur këto llogari që përbëjnë shfrytëzim të burimeve publike, kërkojmë lënien në fuqi të kërkesës së Komisionerit për marrjen e masave administrative ndaj kryetarit të Bashkisë Kamëz, zotit Rakip Suli, në vlerën 3000 lekë dhe kryetarit të Bashkisë Vorë, zotit Blerim Shera, në vlerën 3000 lekë, faleminderit!

Z. K. Bele: Faleminderit! KAS do të tërhiqet për vendim, duke qenë se jemi para një rasti të trajtuar dhe më parë, dakord?!

Z. I. Rusmali: Rasti i trajtuar më parë është njëzet e pesëmijë lekë për shkak të 71/2 dhe një milion lekë të vjetra...

Z. K. Bele: Dakord, po tërhiqemi për të diskutuar, pasi kemi një situatë të ndryshme që kërkon hetim më të thelluar nga KAS-i.

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 15.05.2023*

Rifillon seanca

ora 14:18

Z. K. Bele: Riçelim seancën, në lidhje me kërkesën nr. 31, ndaj vendimit të KSHZ nr. 498, dt.11maj. KAS në përfundim të shqyrtimit në kurum prej katër anëtarësh, duke qenë se për një vendim që kërkohet, nuk arrihet kurumi prej tre anëtarësh, i cili gjithashtu në vendimet e fundit të Kolegjit Zgjedhor është ngritur si një nga shkaqet për të cilin vendimi mund dhe duhet të jetë i vlefshëm, në këto kushte KAS vendos ta pezullojë në këtë fazë, shqyrtimin administrativ. Do të caktojë një datë tjetër për çeljen e shqyrtimit, në kushtet ku dhe anëtari tjetër të mundësohet, pra do të tentohet që të jemi në kurum të plotë për të realizuar këtë vendim. Si datë e tentuar është data e nesërme, data 16.05.2023, ora 12:30. Kjo për të riçelur shqyrtimin dhe për të arritur te vendimi. Me kaq seanca deklarohet e mbyllur.

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**

